



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 140/2024

Prishtinë, më 9.7.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar.

Pjesëmarrës tjerë: Sami Gashi, Salih Hoxha dhe Bedri Baliu, GPLV; Festim Bytyqi, GPAAK; Jeta Huruglica, GPLDK; Arzu Virsevca, ass.deputetes; Ermira Llapashtica, Kuvendi/media, dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 2.7.2024;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr.08/L-295 për kriptopasetet;
4. Formimi i panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit”;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2023;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Jeta Statovci, theksoi se *propozimi i parë* i imi është të shtohet një pikë e rendit të ditës, si pikë 3 me kërkesën për tërheqje nga rendi i ditës së seancës plenare, që mbahet këtë javë shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, në mënyrë që përsëri të shqyrtohet nga Komisioni sepse janë disa çështje që janë ngritur nga një grup i organizatave joqeveritare të kryetari i Kuvendit, e të cilët kërkojnë që disa pika të rishqyrtohen, jo në raport me përmbajtjen e projektligjit por me specifikacione të cilat vlerësohet se dallojnë nga natyra e bizneseve. Ndërsa, *propozimi i dytë* është të hiqet nga rendi i ditës pika për KPMM “Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2023”, sepse bordi i ri ka një muaj që ka marrë mandatin dhe sot raporti i KPMM-së për vitin 2023, duke ditur që as raporti i vitit 2022 nuk është i trajtuar, e shohim si hap të ngutshëm, pasi që bordi fillimisht duhet të njoftohet me gjendjen në atë institucion, me të gjitha materialet të cilat i ka trashëguar, dhe pastaj në një mbledhje të radhës, të ketë mundësi të trajtohet edhe raporti i vitit 2022 edhe ai i vitit 2023.

Kryetari, theksoi se pajtohem që bordi kanë mundur të mos jenë të familjarizuar me punën, por nuk pajtohem që ata për 40 ditë mos ta nxjerrin asnjë vendim institucional dhe ku presin me qindra lëndë për të u trajtuar prej tyre. Natyrisht ata nuk janë përgjegjës për raportin për vitin 2023, ku ia kemi sqaruar edhe në ftesë, menaxhmenti vjen e prezanton raportin, por edhe bordi duhet të jetë këtu. Rregullorja thotë, që ne duhet ti thërrasim t’i shqyrtojnë raportet, ndërsa ju mund ta hiqni prej rendit të ditës, nuk kam asgjë kundër, por në esencë përsëri po vazhdoni të gaboni. Për bordin është më mirë të vinë në një debat, me pa deri ku kanë arritur, a e kanë marrë detyrën, a janë duke e shkelur ligjin me licenca prej se kanë ardhur, a ka Trepça licencë, a ka KEK-u licencë, a ka Ferronikeli licencë, si duan me i zgjidhë këto probleme. Parimisht ju keni me qenë dëshmitarë, që dhjetëra kompani mund ta padisin KPMM-në për mospërgjigje juridike.

Pal Lekaj, theksoi se sa i përket tërheqjes së projektligjit, pajtohem, por nuk e kuptoj sa i përket heqjes së pikës për raportin të KPMM-së për vitin 2023. Ata është e vërtetë që kanë 45 ditë që kanë marrë detyrën, por është e vërtetë që ka ngecje të patolerueshme në këtë institucion për arsye se nuk ishte zgjedhur bordi nga mazhoranca. Këta nuk marrin asnjë përgjegjësi për raportin për vitin 2023, por ne duhet të jemi të informuar saktë pse kjo ngecje, pse nuk kanë proceduar me asnjë licencë që 45 ditë, dhe ku është esenca? Ka ndërmarrje që punojnë pa licencë dhe ka kompani që kanë aplikuar e të cilat janë dëmtuar shumë në këtë drejtim. Ata sot të vijnë këtu të raportojnë për raportin për vitin 2023, por edhe për ndonjë interes tonin për publikun, për kompanitë që janë duke e pësuar.

Jeta Statovci, theksoi se për të gjitha shqetësimet e juaja që korrespondojnë për vitin 2024, ne ishim në vizitë në KPMM, që të njihemi se si është pranuar detyra, si po ecë dinamika, e të gjitha. Aktualisht në rend dite e kemi raportin për vitin 2023, e krerët e institucionit kanë rreth një muaj që kanë marrë detyrën dhe kanë nevojë të familjarizohen me atë se çka është trashëguar, të jepet kohë që ata që janë përgjegjës të raportojnë para komisionit. Ne e kemi pasur me herët menaxhmentin, por menaxhmenti vetëm na ka njoftuar, për arsye se kompetencat dhe përgjegjësitë i takojnë bordit. Ky raport nuk do ti ikë raportimit para këtij komisioni, por vetëm të kenë kohë të mjaftueshme për ta trajtuar atë që ju ka bartur atyre dhe mund të ftohen në një mbledhje të radhës kurdo që vendosim.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, theksoi se ata si bord janë që 45 ditë dhe ne thjeshtë po bashkëbisedojmë, të njihemi për së afërmi për punën e KPMM-së. Nëse nuk raportojnë sot, kanë me raportua pas dy jave dhe nuk kanë ku me ikë.

Pas debatit, Komisioni me gjashtë (6) vota “për” miratoi Rendin e ditës me dy ndryshimet e propozuara nga deputetja Jeta Statovci.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 2.7.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 2.7.2024, u miratua pa vërejtje..

3. Kërkesa për tërheqje nga rendi i ditës së seancës plenare të datës 11.7.2024, të shqyrtimit të Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues

Kryetari, për këtë pikë e ka fjalën deputetja Jeta Statovci.

Jeta Statovci, propozoj që të kërkojmë nga Kuvendi që të tërhiqet nga rendi i ditës së seancës plenare të kësaj jave shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, në mënyrë që përsëri të shqyrtohet nga Komisioni sepse janë disa çështje që janë ngritur nga organizatat joqeveritare, deri te kryetari i Kuvendit, e të cilat duhet të rishqyrtohen.

Komisioni njëzëri vendosi ti kërkojë Kuvendit ta heq nga rendi i ditës, piken 12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, dhe ti kthehet Komisionit për shkak të nevojës për konsultime shtesë, lidhur me propozimet e disa organizatave të shoqërisë civile.

4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr.08/L-295 për krypto-asetet

Kryetari, theksoi se për këtë projektligj kryesuese e grupit punues është deputetja Mimoza Kusari -Lila, të cilës ia kaloi fjalën që të paraqet propozim-amendamentet.

Mimoza Kusari Lila, tha se ky projektligj i ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit, duke përfshirë edhe mbajtjen e dëgjimit publik. Sot e kemi pasur takimin e fundit të grupit punues sepse në ndërkohë janë dërguar disa komente nga Njësia për Inteligjencë Financiare, e të cilat kemi vlerësuar se duhet të shqyrtohen. Nga grupi punues janë nxjerrë gjithsejtë 17 amendamente, të cilat i kemi paraqitur sot para komisionit. Tani raporti me amendamente është i gatshëm për miratim në komision dhe propozoj që projektligji së bashku me amendamentet e grupit punues të votohen në grup dhe të procedohet tutje sipas procedurave.

Pas debatit, Komisioni me gjashtë (6) vota “për”, nxori këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr.08/L-295 për krypto-asetet;*
- 2. Raporti procedohet tutje sipas procedurës.*

5. Formimi i panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit”

Kryetari, theksoi se nesër mbyllet konkursi që e kemi hapur për “Kryesues të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”, ligji e ka paraparë që Komisioni e kryen procesin, por tani të vendosim se a do të jemi ne panel tërë komisioni apo do të caktojmë një panel në përbërje të gjithë grupeve parlamentare, etnike dhe gjinore. Një këshillë paraprake është se deputeti apo anëtari i panelit duhet të jetë i përfshirë në tërë procesin e intervistimit. Ndonjë deputet që s’ka interes më qenë në panel, lirisht ta njoftojë komisionin sot se nuk do të jetë në panel. Paneli pas përfundimit të procesit të intervistimit do të hartojë raportin dhe do ta paraqes para komisionit për miratim.

Komisioni pas votimit, njëzëri, nxori këtë:

Vendim

- 1. Komisioni në përbërje të plotë e përben Panelin për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”;*
- 2. Paneli kryen procesin e intervistimit të kandidatëve dhe i paraqet komisionit raport më shkrim;*
- 3. Deputeti i cili mungon në takimin e parë të Panelit nuk mund të vazhdojë tutje procesin e intervistimit, si dhe deputeti që gjatë procesit tërhiqet nga Paneli konsiderohet sikur të mos kish marrë pjesë fare në këtë proces;*
- 4. Shpenzimet e krijuara nga aktiviteti i këtij grupi mbulohen nga buxheti i Komisionit.*

6. Të ndryshme Çështje vijuese

Kryetari, njoftoi Komisionin se për javën e ardhshme e kemi ministren Rizvanolli për raportim, në lidhje me zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, si edhe nëse mendoni ta shqyrtoni raportin vjetor të ARKEP-it për vitin 2023.

Driton Hyseni, në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës, tha se ne si grup punues ende jemi në fazën e vizitave nëpër ndërmarrjet publike dhe nuk i kemi kryer ende aktivitetet e parapara. Nuk kemi arritur në fazën që ta ftojë ministren, prandaj të shtyhet raportimi i ministres për zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Kryetari, njoftoi se për mbledhjen e radhës mbetet raportimi i ARKEP-it për raport vjetor.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit